



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRIN

01 Nr. / Br 17/17

Nr. i fq. / Br. st -14-

Data: / Datum 26.01.2017

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA Mbledhja e XI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës së
VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:12.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Finesë Cakoli, Habib Mustafa, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e Kompanisë "Uniteti" dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Muharrem Shabani, – anëtar i kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi që pika e shtatë e rendit të ditës të modifikohet ashtu që të hiqet teksti "Njësia në Vushtrri" dhe të bëhet "Uniteti në Mitrovicë SHA". Mandej ai propozoi që të futet edhe një pikë shtesë në pikën në të ndryshme që ka të bëjë me gjendjen aktuale në institucionet parashkollore, me theks të veçantë për rrethanat e krijuara në çerdhen "Dielloni".

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – duke iu referuar çështjes së shkollës në fshatin Maxhunaj ku në këtë objekt janë ndërtuar ballkone jashtë normave dhe rregullave të ndërtimit dhe planit. Në përgjigjen që ajo ka marrë nga drejtorja thuhet se këto ballkone janë bërë në formë të kulmit me qëllim të mbrojtjes së hyrjes së shkollës, kurse tjetri për mbrojtjen e "ngrohjes" së asaj shkolle. Ajo vlerësoi që mbulesa e bërë në formë të ballkonit tek hyrja e shkollës duhet të jetë në formë të drejtë, ndërsa lidhur me këtë çështje kërkoi nga drejtorja që t'i ofrohet projekti i ndërtimit të kësaj shkolle.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – lidhur me kërkesën që të diskutohet dhe të shqyrtohet gjendja e çerdhes "Dielloni" vlerësoi se kjo çerdhe është një biznes privat dhe ceku se nuk e di sa është e rrugës që të diskutojë kuvendi për një biznes privat, i cili me sa duket ka dështuar në menaxhim. Tutje shtoi se ky subjekt ka qenë i interesuar që të vazhdojë veprimtarinë e tij me partneritet publiko-privat me komunën, por komuna nuk ka mjete të planifikuara për këtë çështje. Në fund tha se ky subjekt, ka pasur mjaft vërejtje nga inspektorati dhe ka indikacione që ky biznes po mbyllet dhe vlerësoi se nuk e sheh në rregull që të debatohet në kuvend për këtë çështje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se ajo që e ka shtyrë që të bëjë një propozim të tillë është se ky institucion parashkollor vepron në komunën tonë dhe i njëjti ka pasur pengesa nga niveli qendror, dhe komuna si institucion është përgjegjëse që të interesohet për gjendjen e bizneseve që operojnë në komunë. Në këtë drejtim kërkoi që kjo pikë të futet në rend dite dhe të kërkohet nga Ministria e Arsimit përgjigje se cilat masa janë ndërmarrë ndaj inspektorëve, të cilët kanë inspektuar këtë biznes e të cilët në mënyrë të vazhdueshme e kanë penguar këtë biznes duke mos u dhënë licencat adekuate dhe duke kufizuar numrin e nxënësve e që kjo ka ndikuar direkt

në profitin e këtij biznesi. Në fund kërkoi që kjo pikë të futet në rend dite pasi njoftoi se kjo problematikë ka qenë edhe në media dhe janë përfolur edhe emrat e inspektorëve të cilët kanë penguar këtë biznes.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – propozoi që kjo çështje të trajtohet në kuadër të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2017, kur do të diskutohej për informatën për përfundimin e gjysëmvetorit të parë. Andaj në këtë kuadër do të mund të diskutohej jo vetëm për çerdhen “Dielloni”, por për të gjitha institucionet private parashkollore. Në fund tha se Drejtoria e Arsimit do të duhej që të informonte për gjendjen e institucioneve parashkollore.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se futja e kësaj pike në rend të ditës për shqyrtim do të ishte një gjë pozitive, mirëpo kjo çështje ligjërisht i takon Ministrisë së Arsimit për faktin se këto institucione janë të formuara nga Ministria e Arsimit. Të njëjtat kontrollohen nga kjo e fundit dhe se komuna nuk ka autorizime ligjore që të bëjë diçka në këtë drejtim, andaj për këtë kërkoi që kjo pikë mos të futet në rend të ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se është për keqardhje që në këtë formë po hezitohet që një pikë e tillë me kaq rëndësi të futet në rend dite për shqyrtim. Tutje shtoi se si anëtarë të kuvendit kanë obligim që të japin kontributin për çështje që prekin interesin e përgjithshëm të qytetarëve. Ai propozoi që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se kishte me qenë mirë që kjo pikë të futet në rend të ditës, kjo për faktin se komuna si institucion duhet të merret me problemet që i preokupojnë qytetarët tanë. Tutje shtoi se ky problem është shfaqur edhe në media dhe ceku se në këtë rast bëhet fjalë për fëmijët tanë dhe kjo sigurisht se ka rëndësi të veçantë, andaj propozoi që kjo pikë të futet në rend dite për diskutim dhe shqyrtim.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se nuk ka asgjë të keqe nëse kuvendi kërkon informatë nga subjekti i cili është kompetent që në këtë rast janë inspektorët e Ministrisë së Shëndetësisë, pavarësisht se kemi të bëjmë me një institucion privat këtu po bëhet fjalë për fëmijët tanë, andaj kërkoi që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – kërkoi që kjo pikë të futet në rend të ditës dhe kështu të informohemi me gjendjen aktuale në këtë institucion parashkollor.

Lidhur me propozimin e anëtarit të kuvendit Ilmi Azemi, që të futet në rend dite, informata për gjendjen në çerdhen “Dielloni”, kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 2 vota “kundër” vendosi që kjo pikë të përfshihet në rend të ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi i Komunës pas votimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 16.12.2016;
3. Njoftim lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë rajonale të pastrimit “Uniteti”;
4. Shqyrtimi i Propozim-planit të punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës;
6. Shqyrtimi i Planit të veprimit për transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017;
7. Shqyrtimi i informatës lidhur me mirëqenien sociale, strehimin familjar, përkujdesjen për të moshuarit;
8. Të ndryshme.
 - a). Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës në rastin e fundvitit.
 - b). Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen aktuale në institucionin parashkollor çerdhen “Dielloni”.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – paraqiti vërejtjen e tij në procesverbalin e mbledhës së kaluar, të njëjtat janë përfshirë në procesverbal sipas kërkesës së tij.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – paraqiti vërejtjet e tij lidhur me procesverbalin, ku në diskutimin e tij nuk janë përfshira të gjitha pikëpamjet e tij, andaj këto vërejtje janë përfshirë në procesverbal.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së me vërejtjet e parashtruara më lart.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës mbajtur më 16.12.2016

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme.

3. Njoftim lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë rajonale të pastrimit “Uniteti”

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se auditori në pasqyrat financiare të kompanisë “Uniteti” shpreh rezerva për performancën dhe shpalosjen e politikave kontabël të kompanisë. Tutje sqaroi disa nga mangësitë në këtë raport të auditimit, që vijnë për shkak të menaxhimit jo të mirë të kompanisë “Uniteti”. Te llogaritë e arkëtueshme, auditori nuk ka qenë në gjendje të vërtetojë se a do të inkasohen të gjitha mjetet financiare, për mendimin e saj është dashur të jepjen informacione të detajizuara nga auditori në lidhje me llogaritë e arkëtueshme se sa prej tyre i takojnë vitit 2008 e më herët, kur e dimë që ato të arkëtueshmet duhet të falen dhe sa ka arkëtueshmëri për vitet prej 2009-2015. Kartela të detajizuara, pos kësaj sa ka të arkëtueshme nga bizneset dhe sa nga qytetarët, personat fizikë, në qoftë se ato arkëtueshmëri ju takojnë ju takojnë viteve 2008 e më herët dhe ato fare nuk mund të inkasohen dhe nuk mund të konsiderohen si asete në bilancin e gjendjes së kompanisë “Uniteti”, Po ashtu nëse i analizojmë arkëtueshmëritë e vitit 2014 janë 2,245.374€, ndërsa më 31.12.2015 kanë qenë 2,625.279€. Kështu që kemi rritje bukur të madhe të arkëtueshmërive prej 379,905€. Tutje pyeti menaxhmentin e kompanisë “Uniteti”, pse kjo rritje e arkëtueshmërive. A keni dështuar në inkasimin e mjeteve, apo ku qëndron arsyeja. Te llogaritë e pagueshme, prapë edhe këtu ka shumë mangësi, nuk ka dëshmi të saktë ashtu siç e cek edhe auditori i pavarur. Thjesht nuk janë mbajtur kartelat financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Këto pasqyra financiare nuk janë të besueshme dhe nuk i përmbajnë të gjitha shpalosjet që kërkohen me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) 7. Andaj, siç e cek edhe vetë auditori, për shkak të informacioneve të detajizuara që nuk ju kanë ofruar nga menaxhmenti i kompanisë “Uniteti” që auditori ta kryejë punën e vet sipas SNRF-së

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit tha se kompania “Unitetit” përfaqësimin në bordin e drejtorëve e ka konform numrit dhe vlerës së aksioneve, ku kjo kompani udhëhiqet nga bordi në fjalë. Pastaj lidhur me tarifën për shërbimet që ofron kjo kompani, kuvendi i komunës ka aprovuar Rregulloren për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale, dhe në këtë rast kompania “Uniteti” është vetëm zbatuese e kësaj rregulloreje. Kur bëhet fjalë për pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit të pavarur, ceku se auditori përpos tjerash kur ka folur për opinionin e që sipas tij veç çështjeve të diskutuara shpreh rezervë për pasqyrat financiare, performancën financiare dhe shpalosjen e politikave kontabël të kompanisë, nga gabimet materiale apo mashtrimet e mundshme për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015. Opinioni është deri diku i bazuar, por

auditori nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka elaboruar ashtu siç kërkohet me Ligjin e kontabilitetit, duke filluar nga kapitali i kompanisë, i cili gjithsesi është dashur të jetë i përfshirë në planin kontabël. Sido që të jetë kompania "Uniteti" është duke kaluar në disa vështirësi dhe se në këtë drejtim edhe raporti i auditorit nuk mund të jetë i kënaqshëm. Në këtë rrugëtim kompania edhe pse është e formuar prej tri komunave, neve si Komunë e Vushtrrisë na bënë të ndihemi mirë sepse kryetari i komunës në vazhdimësi ka përkrahur dhe e ka bërë të pamundurën që kompania "Uniteti" të zhvillojë aktivitetin e saj, ku para disa ditësh është nënshkruar një marrëveshje për ofrim më të mirë të shërbimeve. Tutje shtoi se në komunën tonë në të vërtetë ka filluar të zgjerohet rrejtja e ofrimit të shërbimeve nga ana e kësaj kompanie. Kur bëhet fjalë për obligimet duhet pranuar se kompania gjendet në një pozitë të rëndë për faktin se e njëjta ka obligim të madh ndaj administratës tatimore, ka obligime ndaj operatorëve ekonomik, mirëpo edhe komunat kanë obligime ndaj kompanisë "Uniteti" dhe se dy komunat tjera nuk e kanë ndjekur shembullin e Komunës së Vushtrrisë sidomos Komuna e Mitrovicës e cila ka probleme me pagesën e obligimeve ku në këtë kontekst shuma e obligimeve për afro 400,000 €, ku ne si përfaqësues të aksioneve në një mbledhje në Mitrovicë kemi kërkuar që t'i dërgohet bllokada në thesar dhe të bëhet inkasimi i mjeteve, sepse edhe të kërkosh shërbime dhe të mos paguash vërtet nuk ka kuptim. Pastaj shtoi se sa ai është i informuar, Komuna e Mitrovicës një pjesë të vogël të mjeteve e ka paguar, por gjithsesi që kjo komunë më së tepërmi e ka ngarkuar gjendjen e kësaj kompanie, kurse Komuna e Vushtrrisë ka qenë lidere sa i përket përkrahjes, mirëpo problemin më të madh e ka sjell Komuna e Mitrovicës e që kjo ka ndikuar komplet në afarizmin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore nga kompania "Uniteti". Sido që të jetë ne si kuvend e përkrahim iniciativën e kryetarit të komunës që të gjenden alternativa për mbështetjen e kompanisë "Uniteti" në kuptimin që të ofrohen shërbime më të mira për qytetarin, por edhe të krijohen të hyra për kompaninë në mënyrë që të mund të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Në relacion të përmirësimit të gjendjes së kësaj kompanie ai propozoi që të gjenden alternativa që komuna të blejë asete dhe që ato asete komuna t'ia jep në shfrytëzim kompanisë në fjalë. Në përfundim të të gjitha këtyre opinionit i auditorit të pavarur rreth implementimit të standardeve të reviduara në periudhën janar-dhjetor 2015 janë ato të cilat këtë kompani e prezantojnë si të tillë e cila nuk ka një qëndrueshmëri, andaj kishte me qenë mirë që kompania të hartojë një plan për të dalë nga kjo situatë të inkorporohet nëse ka edhe ndonjë projekt tjetër nga dy komunat tjera dhe ky plan të ofrohet me kohë dhe të shikohet mundësia se si mund të dilet nga kjo situatë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – pyeti se kompania a ka planifikuar ndonjë mënyrë më moderne për ta bërë inkasimin e mjeteve apo akoma do t'i inkasojë mjetet me paragon-blloka të cilët krijojnë mjaft hapësirë për manipulim.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – paraqiti vërejtjet e tij lidhur me titullin e raportit ku thuhet auditimi i "Pasqyrave Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur", në këtë rast vlerësoi se duhet të ceket se kush është ai auditor dhe në kuadër të cilit institucion e ka bërë këtë auditim të pavarur. Pastaj ai duke mos u lëshuar në detajet e raportit ceku se nuk i duket mirë edhe mënyra sesi është dhënë opinionit por le të jetë që kjo çështje të diskutohet të instanca më të larta. Tutje shtoi se njësisia jonë në kompaninë "Uniteti" së bashku me komunën është duke bërë përpjekje që ta përmirësojë gjendjen e kësaj kompanie. Në këtë relacion vlerësoi se është fundamentale për qytetarët që të përmirësohet mënyra e menaxhimit të mbeturinave dhe për këtë si kuvend dhe si qeveri komunale janë të interesuar jetësisht që menaxhimi i mbeturinave të jetë sa më i mirë i mundshëm me qëllim që të kemi një ambient të pastër në komunën tonë. Megjithatë ai personalisht nuk është aspak i kënaqur edhe pse kemi përmirësim në këtë drejtim krahasuar me të kaluarën, porse akoma ka mbetur shumë për t'u bërë në këtë drejtim. Lidhur me deponitë ilegale të mbeturinave njoftoi se është bërë një marrëveshje për eliminimin e tyre, ndërsa jemi dëshmitarë të gjithë që nuk është hera e parë tash që po bëhet eliminimi i këtyre mbeturinave, por e keqja është se këto deponi po krijohen sërish. Në këtë rrafsh ceku se si komuna ashtu edhe kompania duhet t'i gjejë metodat që këto deponi të mos

krijohen në të ardhmen. Lidhur me përmasimin e gjendjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave ceku se kuvendi ka aprovuar infrastrukturën ligjore duke aprovuar Planin për Menaxhimin e Mbeturinave, Planin e Veprimit, si dhe Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, pastaj dje është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Uniteti". Një bashkëpunim shumë të mirë komuna jonë ka edhe me Gizin gjerman dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi ekziston një garë (projekt) ku konkurrohet për qasje në fondet e kësaj organizate ku vlera e këtyre mjeteve në këtë garë është afër 3,200.000 € në këtë drejtim duhet të plotësohen shtatë kritere dhe si komunë jemi në hap shumë të mirë që këto kritere të plotësohen dhe të bëhemi përfitues i këtij granti. Mandej një vështirësi tjetër që po e përcjellë këtë kompani është se inkasimi i mjeteve bëhet me bllok-paragon që siç u tha kjo formë lë hapësirë për manipulime financiare, dhe për këtë problematik kemi diskutuar me Gizin gjerman për financimin e një projekti për ofrimin e një softveri ku do të krijohet mekanizmi (programi) për inasimin kompjuterik të të hyrave nga menaxhimi i mbeturinave. Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave, komunat tani kanë kompetenca më të mëdha e që si kryetar i komunës në bashkëpunim me kompaninë mendon që brenda dy viteve këto kompetenca do të mund t'i ushtrojë në plotëni. Në vazhdimi ai apeloj tek kompania, por edhe tek të gjithë pa dallim që të punojnë në shtrirjen e rjetit të ofrimit të shërbimeve për pastrimin e mbeturinave. Në fund tha se do të angazhohet në implementimin e planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe njoftoi se zyrtarët e komunës në bazë të marrëveshjes së nënshkruar do t'i ndihmojnë kompanisë në inkasimin e të hyrave.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – paraqiti vërejtjet e tij lidhur me raportin e auditorit, dhe gjithashtu paraqiti vërejtje edhe për kompaninë "Uniteti" e cila nuk është duke i mirëmbajtur rrugët si duhet, duke faktuar se në fshatin Stanoc dhe Prelluzhë njëra trase e rrugës është e zënë me kontejnerë. Pastaj rruga "Faruk Beqiri", rruga "Jeton Tërstena" dhe rr. "Isa Boletini" janë gjithashtu jo të mirëmbajtura dhe njëra trase e rrugëve është e zënë nga kontejnerët. Andaj lidhur me këtë ai kërkoi që ky problem të sanohet pasi që në këtë formë po pengohet edhe komunikacioni. Në fund tha se edhe pagesat e qytetarëve nuk mund të jenë të kënaqshme kur nuk kemi shërbime cilësore nga ana e kompanisë "Uniteti".

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – pyeti se mjetet eventuale që do t'i përfitonte kompania "Uniteti" njësia në Vushtrri, nga ana e Gizit gjerman, frikësohet se mos ato mjete po i uzurpon kompania regjionale në Mitrovicë.

Agim Hasani, përfaqësues i kompanisë "Uniteti"- paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë duke u përgjigjur në pyetje e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se dëshiron të besojë që inkasimi i mjeteve nga ana e kompanisë përmes bllokave-paragon nuk lë hapësirë për manipulim, por vlerësoi se qytetarët nuk i besojnë kësaj forme të inkasimit të mjeteve financiare, dhe shtoi se kjo formë lë dilema për keqpërdorim edhe tek auditori. Tutje shtoi se koncepti modern i menaxhimit të mbeturinave duhet të implementohet, përndryshe bashkëpunimi i komunës me kompaninë përgjegjëse nuk do të jetë në nivel. Në këtë kuadër ai njoftoi se ditë më parë komuna ka blerë 1250 kontejnerë me qëllim që të krijohet mundësia për ofrimin e kushteve për grumbullimin e mbeturinave dhe rritjen e mbledhjes së të hyrave financiare për kompaninë. Pastaj ceku se në të ardhmen mendohet që kontejnerët të hiqen fare nga përdorimi sepse kjo formë nuk është treguar e suksesshme dhe të orientohemi në modalitetin e mbledhjes së mbeturinave sipas principit derë me derë, për faktin se kjo mënyrë është shumë produktive sepse menaxhohen mirë mbeturinat dhe kemi të hyra të garantuara.

Tahir Krasniqi, përfaqësues i kompanisë "Uniteti"- paraqiti sqarime shtesë lidhur me çështjet e ngritura në kuvend, duke shtuar se nëse do të ekzistonte kushtëzimi lidhur me ofrimin e shërbimeve me pagesat e shërbimit për mbeturina gjendja do të ishte shumë më e mirë dhe apeloj që komuna të shqiptojë më tepër gjoba ndaj shkelësve dhe të gjenden forma për inkasimin e borxheve të kompanisë.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se kompania “Uniteti” do ta ketë përkrahjen e komunës, por kjo kompani duhet të punojë sa më shumë në përmirësimin e shërbimeve. Tutje shtoi se ai si kryetar i komunës do të kërkojë edhe nga policia dhe inspektorët që të angazhohen më tepër në kontrolle dhe shqiptimin e gjobave për hedhjen e mbeturinave në vendet joadekuate.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se nuk duhet të fajësohen anëtarët e kuvendit, për dështimet që ka pasur kompania “Uniteti” sepse nga anëtarët e kuvendit përkrahja çdoherë ka shkuar duke u rritur, por shërbimet e kësaj kompanie vetëm sa kanë shkuar duke u keqësuar, në ç’ rast kemi pasur edhe zvogëlim të numrit të punëtorëve dhe vonesa në pagesat e pagave për punëtorët e kësaj kompanie, por pavarësisht këtyre këta punëtorë duhet të përgëzohen për punën që bëjnë. Kur bëhet fjalë për llogaritë e arkëtueshme ku u cek se nuk i kanë informatat dhe se ka filluar nga viti 2015 ku nuk i kanë informatat e detajizume, por dihet fakti se çdo vit përmbillet me 31 dhjetor dhe është i kuptueshëm fakti se për çdo vit kompania duhet t’i ketë informatat për borxhet dhe realizimin e të hyrave dhe se këto të dhëna duhet t’i ketë çdo kontabilist i çdo kompanie. Në fund tha se hartimi i një plani të veprimit do të mund të ndihmonte për kapërcimin e kësaj situatë dhe do të ndikonte në menaxhimin më të mirë të mbeturinave dhe rritjen e të hyrave, por edhe rritjen e mbështetjes nga ana e komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se përkundër respektit që ka për menaxhmentin e kompanisë “Uniteti”, përfaqësuesi i kësaj kompanie u ngut ku konstatoi se faji për dështimet i takon zyrtarëve të komunës, sepse organet komunale duke përfshirë kuvendin në vazhdimësi çdoherë kanë kërkuar që të përkrahjet kompania në fjalë. Kur bëhet fjalë për kushtëzimet që po pretendohen të vendosen atëherë duhet ditur se nuk do të kemi vetëm një operator ekonomik, mirëpo ne me çdo kusht kemi kërkuar që të forcohet kompania “Uniteti”, të përkrahjen punëtorët, kompania të mbetet në treg, dhe nëse kjo kompani nuk është e aftë, atëherë do të kërkohej që futemi në konkurrencë, dhe në këtë formë do të sigurohen mjetet, por në këto rrethana nuk do të jetë mirë për kompaninë “Uniteti”. Në fund tha se menaxhmenti i kompanisë, duhet ti marrë përgjegjësitë e veta dhe të punojë në përmirësimin e gjendjes dhe jo të hedhë fajin në adresë të komunës dhe anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se kompania “Uniteti” i ka dyert e hapura që të konkurrojë edhe në komunë për të fituar tender për ndonjë projekt për rregullimin e infrastrukturës të ujërave të zeza dhe nëse këta të fundit dëshirojnë të punojnë atëherë mund të përftojnë këto projekte.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se nevojitet një mobilizim i përgjithshëm dhe një përkrahje më e madhe për kompaninë “Uniteti”, që të kemi shërbime sa më cilësore në fushën e menaxhimit të mbeturinave.

4. Shqyrtimi i Propozim-planit të punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2017

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se ky draft-plan ka disa ndryshime të vogla nga viti paraprak dhe propozoi që të hiqet nga plani i punës informata për punën e Zyrës ligjore mandej të hiqet nga ky plan informata për punën e Zyrës së informimit këtë propozim ai e arsyetoi se këto informata janë të inkorporuara në Planin e punës së kryetarit të komunës.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës - propozoi që në muajin janar të futet Plani Vjetor i Drejtorisë së Prokurimit dhe kjo pikë të fuzionohet në kuadër të Planit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2017. Gjithashtu në muajin janar të futet edhe Plani i Veprimit për Rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare për vitin 2015. Mandej në muajin shkurt dhe në muajin korrik thuhet se është inkorporuar informata për pasqyrat financiare, por në muajin korrik emërtimi është raport andaj propozoi që këto dy pika të emërtohen si “informata”. Tutje në muajin prill propozoi që të futet raporti i punës i kompanisë së pastrimit “Uniteti”, por edhe raporti i punës i kompanisë rajonale “Ujësjellësi Mitrovica”. Në muajin qershor propozoi që të futet informata për shfrytëzimin e pasurisë së komunës, kurse

në muajin korrik propozoi që të inkorporohet informata për zbatimin e vendimeve të kuvendit. Pastaj informata lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve e paraparë në muajin nëntor, propozoi që të inkorporohet në muajin janar.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se plani i veprimit i Drejtorisë së Prokurimit si çështje me rëndësi, kishte me qenë mirë që të jetë si pikë e veçantë. Pastaj në muajin mars propozoi që Draft-Rregullorja për Mbrojtje nga Zjarri, (Drejtoria për Emergjencë), kjo pikë duhet të hiqet pasi kjo çështje është e rregulluar nga ministria gjegjëse. Gjithashtu propozoi që informata e Zyrës ligjore dhe Zyrës së informimit propozoi që të mbesin ashtu siç kanë qenë më herët.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – propozoi që në muajin shkurt ose mars të futet në plan të punës, draft-rregullorja për ndarjen e subvencioneve në lëmin e shëndetësisë. Tutje shtoi se përkundër shumës së vogël të subvencioneve për mjekim-shërim edhe ky buxhet po konsumohet shumë shpejt ku deri nga i muaji katërt apo pestë këto mjete po shpenzohen dhe mandej komuna nuk po ka mundësi që të ndihmojë asnjë person. Në fund tha se draft-rregullorja e sipërcekur kishte me qenë mirë që sillet në kuvend për aprovim, ku me këtë rregullore do të sanksionohet mënyra e ndarjes së këtyre subvencioneve ku në këtë rast do të bëhej e mundur që buxheti të mos shpenzohej përnjëherë apo për një periudhë të shkurtër, por të kemi një ndarje proporcionale.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që ky plan i punës është bërë në Komunën e Vushtrrisë dhe jo sikur herëve tjera që ky plan ishte hartuar në Shqipëri në ç'rast u shpenzuan mijëra euro. Tutje paraqiti vërejtje se lidhur me këtë plan nuk janë ftuar shefat e grupeve kuvendare për ta dhënë kontributin e tyre.

Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së - propozoi që në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2017, të inkorporohet si pikë Draft-Plani i Mobilitetit i Komunës së Vushtrrisë dhe kjo temë duhet të trajtohet në muajin janar 2017.

Në përfundim të diskutimeve rreth kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi i Komunës pas votimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017.

2. Diskutimi publik fillon nga data 30 dhjetor 2016 dhe zgjatë deri më 20 janar 2017.

3. Obligohen: Drejtoritë Komunale të Komunës së Vushtrrisë që brenda afatit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi t'i propozojnë temat që do të përfshihen në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017.

4. Sekretaria e Kuvendit ka për detyrë që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'i inkorporojë në Draft-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017 dhe t'ia prezantojnë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin janar 2017.

5. Shqyrtimi i informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se ka disa vendime të kuvendit të cilat nuk janë zbatuar, por një nga këto vendime është ai për formimin e një komisioni nga kuvendi dhe ekzekutivi komunal, i cili ka të bëjë me mbikëqyrjen e dhënies në shfrytëzim të banesave. Tutje shtoi se ky komision i cili është formuar me vendim të kuvendit, ka mbajtur disa takime, por aktualisht ky komision nuk është duke funksionuar, andaj lidhur me këtë çështje vlerësoi se duhet të gjendet një zgjidhje qoftë me ndërrimin e strukturës apo të kryesuesit të këtij komisioni për faktin se njëri nga anëtarët e tij ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtares së kuvendit. Në fund njoftoi se nëse ky komision nuk bëhet funksional, atëherë ai do të japë dorëheqje nga ana e tij.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se duhet të zbatohet vendimi për formimin e komisionit për emërimin e rrugëve, ku anëtarët e këtij komisioni duhet të kompensohen sipas vendimit për punën e tyre.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së – paraqiti sqarime lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që vendimet para se të aprovohen në kuvend të shqyrtohen në mënyrë të gjithanshme nga organet profesionale të administratës në kuptimin e ligjshmërisë, sepse nuk është mirë që vendimet e kuvendit të prishen në shkallë të dytë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

6. Shqyrtimi i Planit të veprimit për transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - së pari e përgëzoi Zyrën e komunikimit me publikun në Komunën e Vushtrrisë për draft-planin e veprimit për transparencë dhe po ashtu e falënderoi për atë se gjatë hartimit të tij kanë qenë të ftuar në tryezën e rrumbullaket për të dhënë edhe kontributin e tyre edhe anëtarët e kuvendit. Gjatë diskutimit të këtij plani udhëheqësi i kësaj zyre Blerim Zhabari e di se cilat propozime dhe sugjerime i kemi dhënë dhe nuk dua që këtu t'i përsërisë prapë ngase një pjesë e mirë e tyre e shoh se janë paraqitur në këtë plan. Tutje tha se ajo që dëshiroj të potencoj sot është se a ka Komuna e Vushtrrisë aq transparente sa ne dëshirojmë dhe si paraqitet në informatat që ne i marrim kohë pas kohe. Duke u bazuar në ato që janë paraparë në këtë plan, unë jam në dilemë se a i kemi realizuar disa nga veprimet, të cilat kanë të bëjnë me transparencën e institucioneve publike të komunës sonë deri tani, si p.sh: Takimet publike të kryetarit të komunës t'i vlerësojmë si të suksesshme apo të dështuara, duke pas parasysh se në to pjesëmarrja çdoherë është e ulët. Dhe shihet se ka më shumë pjesëmarrës nga administrata sesa qytetarë, këtu duhet të hulumtohet se ku qëndron problemi, tek organizimi jo i mirë nga komuna, mosinteresimi për pjesëmarrje të qytetarëve, mosinformimi apo edhe retorika e njëjtte e përdorur në këto takime tash e shumë vite? Ose diskutimet publike p.sh tek buxheti, është e qartë që interesimi i qytetarëve ka humbur dhe po vazhdon të humbet, sepse 80% të propozimeve apo rekomandimeve, të cilat i japin qytetarët nuk merren parasysh, sepse planifikimi i buxhetit bëhet në Durrës e që unë nuk jam kundër, por ta mendojmë mirë se nga kush bëhet planifikimi nga ekspertët e fushës apo protagonistët partiakë. Pastaj tha se shfrytëzimi i rrjeteve sociale, dëshiroj që faqja e komunës të jetë më e pasuar me informacione që është e nevojshme për qytetarët dhe pasqyrimi i aktiviteteve të komunës të jetë më gjithëpërfshirës, ngase krijohet përshtypja se të tjerët nuk punojnë asgjë vetëm aktivitetet e kryetarit të komunës dhe disa bashkëpunëtorëve të tij të cilët paraqiten dhe lë për të dëshiruar në aspektin gjuhësor dhe kreativ (facebook). Shembull konkret kur kemi përhapje të një zjarri në një shtëpi apo biznes në vend të postohet fotografia e ngjarjet, aty postohet fotografia e drejtorit të zjarrfikësve ose kur kemi vërshime postohet fotografia e drejtorit Nezir Klinaku, tek shëndetësia fotografia e drejtorit prapë në ç' rast mendoj se kjo nuk është e hijshme as për syrin e qytetarit që e sheh. Transparenca në procedurat e punësimit, ndoshta këtu edhe nuk kam dilema sepse në këtë fushë kemi transparencë maksimale, pa fije dyshimi, sepse jo vetëm ne por edhe qytetarët e dinë në momentet kur shpallen konkurset se kush do pranohet me emër dhe mbiemër në vendin e caktuar të punës ende pa u kryer procedurat e parapara ligjore. Ajo tha se të gjitha këto dilema i paraqita për të bërë thirrje që institucionet tona të jenë më transparente, më të drejta në nivel të përgjegjësive për të cilat janë të obliguara ligjërisht dhe para opinionit në të gjitha veprimtaritë, të cilat i zhvillojnë në institucionet komunale dhe Draft-planin e veprimit për transparencën e mbështes me kërkesën që ky plan të gjejë realizim në objektivat e tij sepse vullneti i Zyrës për informim ose dhe shumë akterëve të tjerë qytetarë e politik nuk duhet nënvlerësuar, por duhet të përkrahët qoftë moralisht, por mbi të gjitha financiarisht në mënyrë që kjo të gjejë zbatim.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se me qëllim të rritjes së transparencës, Zyra e informimit duhet të njoftojë edhe për konkurset që shpall komuna qoftë në administratë apo në fushën e arsimit me qëllim që të gjithë qytetarët të kenë qasje në këto konkurse.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se kemi një konstatim të përgjithshëm se nga zyrtarët e komunës, anëtarët e kuvendit, por edhe nga monitoruesit e jashtëm se Komuna e Vushtrrisë ka një shkallë të lartë të transparencës në të gjithë sektorët komunal. Tutje shtoi se nëse veç dëshirojmë të flasim diçka ashtu sa për të folur mund të themi çfarë të duam, por nëse dikush vërtet ka fakte për shkelje ligjore sa i përket procedurave të punësimit, atëherë është mirë që ato fakte t'i adresojë në organet kompetente e jo vetë të hedhë fajë pa pasur asnjë fakt të bazuar.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se duhet të bëhet e ditur edhe nga Zyra ligjore, se a ka bazë ligjore që të bëhet emërimi i punëtorëve të arsimit pa u zhvilluar procedurat e konkursit. Mandej në rastet kur mësimdhënëset e caktuara shkojnë në pushim të lehonisë, atëherë zëvendësimi i tyre po bëhet pa konkurs dhe kjo çështje duhet të sqarohet sa a ka bazë ligjore apo jo. Në fund tha se emërimi i këtyre mësimdhënësve po bëhet duke u hartuar një listë e caktuar dhe këto janë bërë nga drejtorë të caktuar.

Musaj Tërbunja, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - paraqiti sqarime lidhur me çështjen e llogaridhënies në çështje të punësimit në lëmin e arsimit duke shtuar se transparenca në këtë drejtim është maksimale. Gjithashtu ai u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Blerim Zhabari, përgjegjës i Zyrës për komunikim me publikun - dha sqarime lidhur me Draft-planin e Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

Në përfundim të diskutimeve rreth kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi i Komunës pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

2.Për zbatimin e këtij plani kujdesen: Kryetari i Komunës, Zyra për Komunikim me Publikun, Njësia e Personelit, Zyra Ligjore dhe drejtoritë komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017”, (i cili ka gjithsej 7 faqe).

7.Shqyrtimi i informatës lidhur me mirëqenien sociale, strehimin familjar, përkujdesjen për të moshuarit;

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – tha se në informatën për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë ceket se 21 familje në komunën tonë i mbështesin financiarisht në pagesën e qirasë brenda vitit, ku është e destinuar një shumë prej 24,000 euro për projekte dhe mbështetjes financiare për familjet që nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit dhe jetojnë në kushte tejet të vështira. Gjithashtu në komunën tonë janë ndërtuar gjatë këtij viti 5 shtëpi në bashkëpunim me donatorët dhe nga buxheti i komunës kanë participuar me shumën prej 8.000. euro. Andaj lidhur me këto çështje propozoi që komuna jonë t’iu kushtojë edhe më shume kujdes këtyre familjeve skamnore, të ndajë mjete më shumë nga buxheti i komunës, të heq ndonjë projekt për asfaltimin e rrugëve rurale që nuk ka banorë dhe ato mjete të dedikohen për ndërtimin e shtëpive të familjeve me nevojë, si dhe të hyrat vetanake nga taksat në firmë të dedikohen për ndërtimin e shtëpive. Propozimi për heqjen e tasksës në firmë për biznese ka qenë një gabim sepse buxheti i bizneseve është buxhet më i madh sesa buxheti i Komunës së Vushtrrisë, prandaj propozoi që deputetët që kanë inicuar për ta hequr këtë taksë të mbesin në komision dhe t’i vizitojnë komunat tjera, të cilat ende e aplikojnë këtë taksë si p.sh. Komuna e Mitrovicës, Skënderajt, Podujevës, Ferizajt, Pejës, Gjilanit etj. Në fund tha se po ua them një citat nga MAPL, ku të hyrat nga veprimtaritë afariste vazhdimisht janë në ulje gjë që duhet të shikohen vendimet e komunës për të rikthyer aplikimin e kësaj takse.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se sa i përket Informatës për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë duke e ditur se jo vetëm në komunën tonë, por në përgjithësi në Kosovë gjendja sociale e qytetarëve është pothuajse mjaft e rëndë dhe duke i krahasuar me sfidat edhe të drejtorisë dhe të qytetarëve, mendoj se kjo informatë është e mangët dhe është e përgjysmuar, pa detaje, sepse unë nuk mësova asgjë nga kjo informatë, por besoj që as ju nuk e keni të qartë edhe aq shumë. Kështu që kisha pas dëshirë të kem një informatë më të detajuar nga ju drejtor, prandaj kam një pyetje konkrete, duke shtuar se ju si drejtori a keni ndonjë projekt për t'iu ndihmuar përmes ndonjë pune banorët që janë me ndihma sociale për t'i vetëdijesuar, sepse e di që ndihmë sociale marrin edhe njerëz të cilët janë të aftë për punë dhe e di që drejtorja juaj nuk ka mundësi që t'i punësojë në punë të përhershme këto kategori, por a ka projekte sezonale apo projekte tjera, në ç'rast mendoj që mund të keni ide më të mira sepse ju si drejtori ballafaqoheni me këtë kategori dhe a ka ndonjë projekt që këta persona që gëzojnë ndihmën sociale që në një formë të punojnë dhe ta meritojnë atë ndihmë, dhe përmes këtij projekti të punës qytetarët të vetëdijesohen se kanë mundësi të punojnë sepse është krijuar një përshtypje nga disa qytetarë të përkushtohen për rregullimin e dokumentacionit për vazhdim të ndihmës sociale e jo të punojnë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se gjendja sociale në Komunën e Vushtrrisë edhe në bazë të kësaj informate e cila i pasqyron deri diku faktet mbi gjendjen e rëndë të cilën po e përjetojnë qytetarët tonë, mua me intereson të di konstatimin në fillim të faqes së 2-të. Në informatë thuhet se raste sociale të përfshira në skemën e asistencës sociale gjatë vitit 2016 ka qenë 1459 familje, rrjedhimisht 4926 banorë, ndërsa në vazhdim thuhet se në muajin mars të vitit 2016 raportet flasin për 1388 familje që janë shfrytëzuese të ndihmës sociale, prandaj është një paqartësi në këtë raport, kështu që dëshiroj të them se komuna gjegjësisht drejtorja bën mbështetjen financiare me pagesë të qirasë për banim për 21 familjeve skamnore. Mirëpo edhe pse kemi pasur diskutime, propozime dhe kemi kërkuar që të fillohet me partneritetit publiko-privat për ndërtimin e një objekti për banim të rasteve sociale që është kategori ligjërish e njohur edhe disa komuna veç e kanë aplikuar këtë skemë, parcela për ndërtim është e ndarë, prandaj nuk e di se a ka filluar diçka nga zyra juaj për këtë e cila kishte me qenë në interes të përgjithshëm ku nuk do të kishte nevojë të paguhet qiraja për 21 banesa dhe do të krijonim banim shtesë për këtë kategori me nevojë, prandaj kisha dëshiruar të jemi të njoftuar se a do ta procedoni pasi që partneriteti publiko-privat shkon nëpërmes një komisioni ndërministror në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe është pak me mundime, por efektet përfundimtare janë shumë pozitive, për arsye se jepet një mundësi që të zgjidhet çështja e banimit social për kategoritë me nevojë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës nuk e pata ndërmend të dal dhe të diskutoj pasi që e kam dhënë kontributin tim edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF), por me nxiti fakti i diskutimit të zonjës Melihate që iu drejtua drejtorit për informatë e cila është e mangët dhe më bën të hamendem se qysh munden drejtorit të na e sjellin të njëjtin material si në komitet ashtu edhe në seancë, megjithëse aty merren vërejtjet sugjerimet nga anëtarët e komitetit që të inkuorohen e pastaj të vijnë me material për kuvend. Tutje tha se konkretisht po ju informoj se çka i kam sugjeruar drejtorit për informatën në rend të ditës lidhur me strehimin e familjeve dhe kategoritë për strehimin dhe përkujdesjen për të moshuarit, ku kemi kërkuar edhe për ndërtimin e një shtëpie të pleqve, prandaj kam kërkuar që të jenë të shënuara edhe në informatë për këto raste.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së – tha se realisht informatën e kam këtu prezent dhe e dimë se gjendja sociale në Komunën e Vushtrrisë nuk është shumë e mirë, ajo çka u diskutua për shifrat është e vërtetë që është synuar, te paragrafi i faqes së dytë ku fillimi i vitit ka filluar me 1388 familje që kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale dhe më pas është rritur ky numër ku gjatë këtij viti ka arritur shifrën prej 1459 familje me asistencë sociale, dhe është nxjerr numri i anëtarëve të këtyre familjeve. Tutje tha se është mirë që këto kërkesa t'i parashtroni më herët kur të ndahet buxheti dhe të bëhet ndarja më racionale. 16,500 euro i kemi

pasur në dispozicion për shërim për gjendje të rëndë sociale për këtë kategori dhe nuk ka qenë shifër e mjaftueshme për të gjitha kërkesat që na janë drejtuar, kurse 376 kërkesa janë të regjistruara këtë vit, ndërsa 130 kërkesa janë të realizuara, prej tyre 76 kanë qenë në ndërtim, ndër të tjera 29 janë realizuar, duke i përfshirë edhe 21 familje që iu është paguar qiraja, gjithashtu 65 familje kanë qenë nga rastet sociale për ushqim, miell e gjësende të tjera. Krejt kjo punë është bërë me këtë shumë 16.500 euro për këto raste dhe 24.000 euro që kanë qenë për pagesë të qirasë. Në vazhdim tha se pjesën tjetër të shumë familjeve që nuk kemi pasur mundësi t'ju ndihmojmë prej buxhetit, i kemi realizuar prej ndihmave të ndryshme me bashkëpunëtorë ku kanë qenë përfitues 630 familje, ndër të tjera edhe 5 shtëpi që kanë qenë në bashkëpunim me donatorë dhe participimi i komunës ka qenë 8.000 euro, për dy familje nga 2.000 euro dhe 4.000 euro për një familje. Sa i përket çështjes të të moshuarve ju informojë se Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me Qendrën e të moshuarve në Komunën e Skënderajt ka arritur që të dërgojë një të moshuar në atë qendër dhe kanë qenë edhe 7 kërkesa tjera ku nuk kanë mundur me i proceduar në Qendrën e të moshuarve pasi që ligji nuk ua mundëson sepse ata të moshuar i kanë fëmijët e tyre. Një projekt që e kemi biseduar edhe me kryetarin dhe po planifikojmë në vitin e ardhshëm ta realizojmë përderisa nuk po kemi mundësi të ndërtojmë një shtëpi për pleq, kurse prej fondit të shëndetësisë janë destinuar 30.000 euro për përkujdesje shëndetësore. Gjithashtu kemi pranuar një letër konfirmuese prej një donatori në shumën prej 15.000 euro për këtë projekt ku totali i kësaj shume arrin vlerën 45.000 euro dhe mundet me qenë në funksion të një ekipi mjekësor që i ofron shërbimet mjekësore në shtëpi për të moshuarit dhe për personat me nevoja të veçanta. Sa i përket punësimit sezonal kemi pasur një takim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë zhvilluar disa biseda ku pastaj është biseduar me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik dhe është synuar që të ketë projekte dhe programe të tilla, por nuk ka pasur një bashkëpunim të mëtutjeshëm me Drejtorinë e Shëndetësisë. Çështja e qirasë e atyre familjeve është se kanë hyrë që një kohë të gjatë dhe nuk iu është ndryshuar për të mirë gjendje atyre familjeve.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se gjendja sociale e qytetarëve është jo e mirë dhe për këtë është në dijeni edhe drejtori, mirëpo ajo u ndërlidh me parafolësen Bahrije Pllana lidhur me ndryshimin e pikave të seancës së radhës se duhet të plotësohen dhe ndryshohen nga komiteti deri në seancë.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se me të vërtetë është një çështje e ndjeshme të flitet për punën e çështjes sociale të qytetarëve tonë qoftë të individëve apo familjeve me gjendje të rëndë sociale dhe duhet të punohet më shumë angazhim dhe përkushtim në këtë drejtim. Informata ka mundur të jetë edhe në ndonjë formë më të qartë dhe të jepën sqarime më shumë nëse ka nevojë të vijnë me emër e mbiemër se kush ka përfituar nga subvencionet, fatkeqësisht subvencionet në si komunë i kemi të pamjaftueshme dhe janë të vogla në raport me komunat tjera, ku në vitet e kaluara Komuna e Mitrovicës subvencionet i ka pasur mbi 500.000 euro, pasi që limitin e subvencioneve po e cakton qeveria dhe nuk po mund t'ju dalim në ndihmë më shumë këtyre kategorive me gjendje të rëndë sociale apo shëndetësore. Këtu bëhet fjalë për lloje të ndryshme të kategorive si të moshuar, të hendikepuar, të shurdhmemecëve e shumë kategori tjera, por nuk kemi mundësi të bëjmë të gjithëve përnjëherë t'ju dalim në ndihmë. Tutje tha se sa i përket çështjes së punësimit nuk mund të themi se s'kemi të papunë, por në Komunën e Vushtrrisë shumë biznese po ankohen se nuk po kanë numër të mjaftueshëm të punëtorëve për të punuar në firmat e tyre, siç është rasti i fabrikës së "Vipa Çips" e cila kërkon punëtorë nga komunat tjera. Mandej tha se këtë vit kemi pas projekte sezonale ku kemi pasur marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale së paku dy projekte. Gjithashtu kemi pasur marrëveshje me GIZZ-in dhe USAID-in. Idea e Ilmiut për partneritet publiko-privat mund të ndihmohen kategoritë që kanë nevojë për strehim, por tash nuk është një vit i plotë i mandatit tim dhe nuk kemi të drejtë, kështu që e kemi ndarë një parcelë prej 80 ari dhe janë ndarë si në vijim: Për familjet e dëshmorëve 40 ari, për familjet skamnore 20 ari dhe për invalidë të luftës 20 ari. Në vazhdim tha se disa herë kam pas premtime prej Emirateve

të Bashkuara Arabe se do të fillojnë në pranverë, por nuk kemi asgjë konkrete në këtë drejtim, kurse kemi bërë kërkesa disa herë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'na ndajë mjetet edhe me bashkëfinancim, por nuk kemi asgjë konkrete për ta ndërtuar ndonjë objekt. Në fund tha se kemi filluar ta ndërtojmë Qendrën për Nevoja të Veçanta në fshatin Nedakoc dhe pushim ditor në bashkëpunim me Komunën e Vaxjë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket çështjes së çerdhes "Dielloni" të gjithë e kemi parë edhe përmes mediave, konsideroj që është e nevojshme të kërkojmë një informatë me kërkesë të kuvendit nga Ministria e Punës, konkretisht nga inspektorati i punës i ministrisë dhe të dimë se si janë çmimet dhe shërbimet e çerdhes publike dhe asaj private, dallimin në mes tyre.

8. Të ndryshme

a). Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës në rastin e fundvitit.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se së pari po ju kujtoj se buxheti i planifikuar prej Qeverisë së Kosovës për vitin 2016, ka qenë 14,587.91 euro, nëse i kemi parasysh edhe mjetet e bartura të viteve të kaluara mund të themi se 459,300 euro janë mjete të bartura nga vitet e kaluara, atëherë mund të themi se buxheti për këtë vite kap shifrën prej 15,46.391 euro, duke iu referuar shpenzimeve të buxhetit deri më tani: Projekte të realizuara në investime kapitale gjatë vitit 2016 janë 275 projekte dhe vlera në euro e gjitha shpenzimeve në investime kapitale është 6,454.59 euro. Realisht komuna i ka shpenzuar 2,965.000 euro, ndërsa komuniteti 22,374 euro, investime të qeverisë 390,167 euro, ndërkaq donacione janë 3,76.514 euro, në qoftë se e konsiderojmë edhe atë si donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe për renovimin e Spitalit "Sheik Zayed Hospital" në Vushtrri 6,990.000 euro, atëherë shuma e investimeve kapitale në komunën tonë do të arrijë vlerën prej 13,444.59 euro. Tutje tha se është mirë dhe e rendit që ne si qytetarë edhe si kuvend gjithashtu edhe si kryetar me i përmend dhe falënderuar donatorët që kanë investuar në komunën tonë si: Qeveria Norvegjeze 110,000 euro, në një projekt për punimin e tabelave dhe numrave të rrugëve dhe vendbanimeve; USAID- një projekt për ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimin publik prej fshatrave Stanoc deri në fshatin Prelluzhë në vlerën prej 100,000 euro, gjithashtu USAID- ka investuar në vlerën prej 5,320 euro në dy e-kioske njëra te objekti i komunës, kurse tjetri afër Qendrës së regjistrimit të automjeteve; Lux-develtmen, - ka investuar 460,000 euro në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, natyrisht ky projekt ka qenë në bashkëfinancim me komunën që participon me vlerën 300,000 euro; CDI-Zvicerane – është në realizim e sipër në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Qyçavicës në vlerën prej 985,000 euro; Qeveria zvicerane- ka investuar në një projekt me vlerën 28,600 euro për ndërtimin e disa shtëpive për 22 familje- shqiptarë, si dhe të komuniteteve serb dhe romë. Pastaj projekti për ndërtimin e një objekti për banim të rasteve sociale nga një OJQ-TJZ, në bashkëpunim me kompanin "Ariani Company" që e kanë ndërtuar një shtëpi në vlerën prej 30,000 euro. Kur flitet për kompanin "Ariani Company" vlen të theksohet se kam informata se kanë ndërtuar dhe renovuar disa shtëpi, vlera e të cilave është 150,355 euro; "HELP"- organizatë gjermane - ka investuar në një projekt në shumë 105,55 euro për mbështetje për mikro-bizneset në komunën tonë; IADK-ja,- i ka realizuar dy projekte në komunën tonë, një për furnizim me fidane në vlerën 32,200 euro, kurse tjetri projekt për këshilla në sektorin e blegtorisë në shumën 6,950 euro; organizata holandeze "Bosporos"- ka realizuar një projekt për renovimin e objektit shkollor në fshatin Stanoc në lagjen "Caka" me shumën prej 21,500 euro; organizata "Tika" – i ka realizuar dy projekte, një projekt për pajisje me inventar në kabinetin e shkollës së mesme të gjimnazit në vlerë prej 12,800 euro, dhe projekti tjetër në çerdhen publike të qytetit investime dhe tranjime në vlerën prej 13,000 euro. Gjithashtu kemi pasur një donacion nga një bashkatdhetar yni për shkollën fillore në fshatin Zhilivodë emri i të cilit mbetet ende i panjohur për arsye bamirësie në shumën prej 3278 euro. Po ashtu edhe një

tjetër donacion ka qenë nga dy vëllezërit Avdullah dhe Berat Kovaçi në renovimin e shkollës dhe blerjen e disa pajisjeve sportive në shkollën e Novolanit në shumën prej 20,000 euro; “Korpusi i Paqes” – një organizatë e themeluar nga bashkatdhetarët tanë nga Zvicra ka investuar në pajisjet për kabinet në shkollën e mesme të ulët në vlerën prej 2054,euro; Zyra e BE-së, në Prishtinë – i ka realizuar dy projekte në vlerën prej 26,500 euro, njëri projekt për pajisje për teknologji informatike në SHMU-2 dhe tjetri një shumë prej 158,000 euro këtë vit për Qendrën për grumbullim, paketim dhe sortim në fshatin Bukosh; Armata e SHBA-ve , - ka dhuruar një donacion me vlerën prej 407,262 euro, për renovimin e objektit të shkollës së mesme “Lutfi Musiqi” në Vushtrri; Global Relief nga SHBA-të,- ka investuar në një projekt me vlerën 423,640 euro, për institucionet e mjekësisë në komunën tonë për furnizim me pajisje dhe material shpenzues të qendrave të mjekësisë, por edhe për spitalin tonë; organizata “Patien Help Fund”- i ka realizuar dy projekte, njëri prej 95,000 euro për ndërtimin e një qendre të mjekësisë familjare në Vushtrri, në një tokë të Bashkësisë Islame në periferi të Vushtrrisë përkatësisht tek “Podranqa”, kurse tjetri projekt për ndërtimin e një Qendre për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakofc me vlerën 86,000 euro; Këshilli Evropian,- një projekt prej 12,100 euro, për hartimin e planit të veprimit për komunitetet joshumicë; organizata “:Albanor” – një organizatë nga Norvegjia ka investuar në ndërtimi e tri shtëpive ku kemi qenë edhe ne si komune bashkëfinancues, ku shuma totale ka qenë 37,000 euro; Emiratet e Bashkuara Arabe – kanë investuar në spital në shumën prej 6,990.000 euro. Mund t’ju them me kënaqësi se shpenzimet e grantit qeveritar mund të themi se e kemi shpenzuar pothuaj se qind për qind ose më sakt 99,36 %, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të buxhetit arrijnë shifrën 96,67% që i kemi realizuar e që mund të arrihet edhe më shumë në këto ditë të fundvitit. Pastaj tha se nga 77 projekte të investimeve kapitale që i kemi planifikuar ne si kuvend i komunës mund t’ju them se 66 projekte janë të realizuara, kurse kanë mbetur në realizim e sipër ose ne bartje për vitin e ardhshëm edhe 10 projekte që shuma e tyre është 141,000 euro dhe të gjitha janë mjete nga të hyrat vetanake, duke shtuar se brenda këtij viti ndërtimi i fabrikës së ujit ka qenë një projekt madhor, në infrastrukturë rrugore kemi vazhduar të punojmë në 66 fshatra sa ka komuna, ndërkaq na kanë mbetur vetëm dy fshatra pa i asfaltuar siç janë fshatrat Shlivovicë dhe Skoçan pa u asfaltuar ende. Duke iu referuar shëndetësisë kemi të arritura në shërbim të gjithë qytetarëve, po ashtu edhe në bujqësi ku kemi subvencione nga ministria në gjithë sektorë,t si në prodhimin e patates ku identifikohemi ne si komunë, pastaj industria e mobilerisë është në zhvillim e sipër dhe duhet të krenohemi ne si komunë që po eksportojnë shumë kompani në botën e jashtme; industria e ndërtimit është shumë e fuqishme në komunën tonë, një fakt që na është shfaqur nga një organizatë për vlerësimin e nxënësve me rezultat të dobët në arsim në nivel vendi, nuk mendoj që është një realitet në arsimin tonë. Ne menaxhimin e mbeturinave duhet të punohet ende më shumë, kemi pasur një menaxhim të mirë në kohën e vërshimeve që patëm tash në kohën e fundit dhe disa zjarreve që kemi pasur ku konsideroj që kanë qenë zjarre të qëllimshme dhe duhet të punohet që të eliminohen këto dukuri. Kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me organizatat si “Handikos”, shoqata “Drita Jonë”, shoqëritë civile, KFOR-in, USAID-in, OSBE, GIZ-in, Cdi, Lux Development etj. Në fund i uroi të pranishmit për një vit të mbarë e të suksesshëm.

b). Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen aktuale në institucionin parashkollor çerdhen “Dielloni”.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket çështjes se çerdhes “Dielloni” të gjithë e kemi parë edhe për mes mediave dhe konsideroj që është e nevojshme të kërkojmë një informatë me kërkesë të kuvendit nga Ministria e Arsimit, konkretisht nga inspektorati i ministrisë së arsimit dhe të dimë se si janë çmimet dhe shërbimet e çerdhes publike dhe asaj private, dallimin në mes tyre.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2016, nga Ministria e Arsimit ka kërkuar që të informohet me sa vijon:

Pas rrethanave të krijuara në institucionin parashkollor "Kopshti Dielloni" në Vushtri kërkon nga e lartcekura që të informohet për gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe cilat masa janë ndërmarr nga ana juaj si institucion kompetent.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Finesë Hajrizi, anëtare e kuvendit – duke e bërë një prezantim të shkurt të biografisë së saj shfytëzoi rastin të tregojë se rruga e këtij fshati është në gjendje jo të mirë ku bora e pare që bie kjo rrugë bëhet e pakalueshme. Është asfaltuar një pjesë e kësaj rruge "Gjelbishta" gjatë periudhës 2011-2013, dhe me pas afro 4 muaj është dëmtuar për shkak se nëpërmes kësaj rruge zbarkojnë kamionët me pesha të rënda nga gurthyesit nga fshati Tërllobuq e që dua të them se Drejtoria e Urbanizmit nuk e ka paraparë se në këtë rrugë mund të qarkullojnë automjete me pesha të rënda, me pas janë hedh disa kamionë me zhavorr, por prapë nuk është në gjendje të mirë. Tutje tha se rruga "Kastrati" që konsiderohet si rrugë e rendit të katërt, por asnjëherë nuk është shtruar me zhavorr, kurse rruga anësore është shtruar e kjo kryesore jo. Nuk jam kundër shtruarjes së rrugëve, por jo të lihen anash. Gjithashtu edhe sa i përket ujit të pijshëm si nga pushteti i mëparshëm ashtu edhe nga ky aktual kemi qenë të lënë anash fshati Sllatinë dhe fshatarët detyrohen të përdorin ujin e prrockës që konsiderohet si ujë mjaft i kontaminuar, njëherit edhe grumbullimi i ujërave të zeza është mjaft shqetësues. Gjendja e shtyllave elektrike është alarmante dhe se kurrë njëherë nuk kemi marrë përgjigje. Meqenëse jeni në çerekun e shekullit njëzetënjë XXI. Në fund pyeti kryetarin dhe drejtorin e urbanizmit se në cilin vit banorët e fshatit Sllatinë do t'i gëzojnë të drejtat e asfaltimit të rrugës, ujësjellësit, kanalizimit dhe ndriçimit sikurse fshatrat tjera.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – kërkoj përgjigje me shkrim nga Zyra ligjore për konkurset e mëhershme lidhur me pranimin e punëtorëve në SHMU- 1.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës - tha se është e vërtetë se ajo rrugë në fshatin Sllatinë-Tërllobuq është në gjendje të keqe, jo vetëm në atë fshat, por edhe një segment i fshatrave Bukosh dhe Maxhunaj. Kompania e cila i ka kryer punimet qysh është e paraparë me kontratë nuk e ka kthyer rrugën në gjendjen e mëparshme dhe janë inicuar të gjitha procedurat nga Drejtoria e Prokurimit në gjykatë dhe fazën e parë e ka fituar komuna, por pala tjetër është ankuar dhe ne e dimë procedurën e gjykatave të ngadalshme. Rruga nga pompa e derivateve në dalje të qytetit për në Mitrovicë, përkatësisht në fshatin Sllatinë, vërtet është në gjendje të keqe, por do të rregullohet shpejt, kurse po në këtë fshat disa lagje të janë asfaltuara, nga lagja "Hajrizi" që vazhdon për në fshatin Tërllobuq Në fund tha se edhe këto rrugë të mbetura përgjysmë shpejt do të lidhen si në fshatin Taraxhë dhe Sllatinë, kurse kërkesa sa i përket ujit të pijshëm në fshatin Sllatinë këtë vit do të fillojë projekti nga Lux Development në ç'rast do te renovohet rezervuari i ujit dhe të shtrihet rrjeti i ujit në tërë fshatin.


Mbledhja përfundoi në ora 13:05.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Muharrem Shabani



Anëtar i Kuvendit